

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9942, datë 26.6.2008 për “Parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	VKM nr. 439, datë 17.5.2017 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2016 – 2020", pika 1.3.2 “Shëndeti në të gjitha politikat”; VKM nr.348, datë 11.05.2016 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”, pika 3.1.2 “Shëndeti si kontribues për zhvillim dhe integrim”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	23.08.2018
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	20.11.2018
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	13.11.2018
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2018 – MSHMS - 01
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Nexhila Kodra nexhila.kodra@shendetesia.gov.al ; +355694490328 Thanas Bello thanas.bello@shendetesia.gov.al ; +355674974778 Eneida Capo eneida.capo@shendetesia.gov.al +355696996606

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Jodi është një mikroelement natyror i rëndësishëm për organizmin e njeriut dhe të kafshëve. Prania e sasisë së nevojshme të jodit ka rëndësi në drejtim të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit publik, me fokus përmirësimin e cilësisë së jetës së popullatës.

Mungesa e sasisë së nevojshme të jodit (pamjaftueshmëri jodike) ose mos-marrja e tij në nivelet e duhura/të rekomanduara (deficienca jodike), shoqërohet me pasoja të rënda për shëndetin e njeriut që ndikojnë në zhvillimin intelektual dhe fizik të njeriut si: prapambetje mendore, defekte fizike, strumë, duke sjellë dëmtime të rënda veçanërisht tek gratë shtatzëna dhe fëmijët.

Pavarësisht progresit aktual për eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike në popullatën shiptare ende vijojnë të jenë të pranishme çrregullime si pasojë e marrjeve të mangëta

ushqimore të jodit në popullatë. Problemi kryesor sot në Shqipëri vijon të jetë deficienca jodike, që ka pasoja negative në shëndet, veçanërisht në zhvillimin e fëmijës dhe shfaqjen e potencialit të plotë jetësor në moshën adulte.

Mënyra më efikase për eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike në popullatë si problem i shëndetit publik është jodizimi universal i kripës për konsum njerëzor shtazor dhe në industrinë ushqimore. Një nga prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka qenë dhe mbetet eliminimi i pamjaftueshmërisë jodike në popullatën shqiptare gjë që reflektohet në disa dokumenta strategjikë të miratuara.

Referuar ndryshimeve ligjore të vitit 2013 që prekën rolet e institucioneve aktuale, lindën probleme në zbatimin e ligjit, në drejtim të inspektimit dhe monitorimit të kripës së jodizuar duke lënë të papërcaktuar në legjislacion mekanizmat institucionalë kontrollues dhe monitorues.

Rrjedhimisht lind nevoja për disa ndryshime fokusuar në komponentët e inspektimit dhe monitorimit të kripës së jodizuar dhe rolin e institucioneve të përfshira në to si: përcaktimin e institucioneve që do bëjnë monitorimin dhe inspektimin e kripës, ndarjen e qartë të kompetencave për procesin e monitorimit, dhe dhënien e detyrave të çdo institucioni, duke shmangur mbivendosjet dhe plotësuar boshllëqet që ekzistojnë aktualisht.

Sa më sipër, është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë, për të përcaktuar mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës së jodizuar nga institucionet e përfshira, për të forcuar zbatimin e ligjit për rritjen e sigurisë, cilësisë, së kripës ushqimore të jodizuar, elementë të cilët ndikojnë në shëndet, e për rrjedhim në mirëqënien e popullatës.

Me këtë ndërhyrje/politikë në këto komponentë, do të mund të sigurohet një sistem kontrolli më i mirëmenaxhuar, i cili është thelbësor për sigurimin e suksesit dhe qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve që synojnë eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike në popullatën shqiptare në drejtim të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit publik.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesorë të këtij propozimi janë:

1. Të kontrollohet në masën 100 % kripa ushqimore e prodhuar nga stabilimentet e jodizimit të kripës ushqimore në Republikën e Shqipërisë;
2. Të kontrollohet në masën 100 % kripa ushqimore e importuar në Republikën e Shqipërisë përmes marrjes në kohë të mostrës dhe analizës laboratorike për nivelin e jodit, në çastin e futjes së kripës në pikat doganore në RSH.
3. Të monitorohet në masën 100 % të mbulimit të territorit të vendit, niveli i përmbajtjes së jodit në kripën ushqimore, bazuar në zbatimin e një metodologjie kampionimi përfaqësuese të të dhënave në nivel kombëtar sipas planifikimit vjetor të monitorimit nga strukturat vartëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në nivel kombëtar dhe rajonal.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0:- status quo-ja: në kushtet e zbatimit të ligjit aktual, me ndryshimet ligjore të vitit

2013 që prekën rolin e institucioneve në drejtim të kontrollit dhe monitorimit, krijuan situatën ***ku mbeten të papërcaktuara në legjislacion, mekanizmat e inspektimit dhe monitorimit institucional.***

Në këtë situatë nëse nuk ndërhyjmë me rregullime ligjore, atëherë mbetet i paqartë si dhe konfuz fakti se si mund të arrihet të matet zbatimi i detyrimeve ligjore të çdo institucioni në drejtim të inspektimit dhe monitorimit të cilësisë së kripës së jodizuar, si dhe zbatimin konkret të ligjit për parandalimin e çrregullimeve që vijnë prej pamjaftueshmërisë jodike, e lidhur me verifikimin e sigurisë, cilësisë dhe standardeve për konsumin e kripës së jodizuar, elementë që ndikojnë në shëndetin e mirëqënien e popullatës.

Opsioni 1: Miratimi i një ligji të ri, si bazë ligjore për një model zbatimi të ri

Opsioni 2: Ndryshimi i ligjit ekzistues.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuara dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuara mbi buxhetin dhe bizneset.

Në situatën aktuale, pra të status-quo-së, referuar boshllëqeve ligjore që lidhen me problemin e mungesës së mekanizmave institucionalë monitorues dhe kontrollues dhe rolin e institucioneve konkrete, problemet në zbatimin e ligjit, i cili synon parandalim, do të jenë të pashmangshme.

Përsa i përket Opsionit 1, miratimi i një ligji të ri si model zbatimi, edhe ky opsion nuk do të zgjidhte situatën aktuale, pasi bazat e kriterëve dhe kërkesave ligjore themelore janë tashmë të sanksionuara në ligj, të cilat janë të matura referuar kushteve të popullatës shqiptare.

Në mungesë të ndërhyrjes me këtë politikë, supozojmë se niveli i jodizimit të kripës apo cilësia e kripës së jodizuar, pa një forcim të zbatimit të ligjit dhe ndarje të qartë të kompetencave mes organeve përgjegjëse, nuk përmbush objektivin themelor për parandalim dhe eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike që sjell pasoja në shëndetin publik, me fokus popullatën.

Ndikimet Ekonomike

Opsioni 2 nuk parashikon të ketë ndikime financiare direkt në buxhetin e shtetit, sepse zbatimi i këtij opsioni i referohet strukturave aktuale për zbatimin e legjislacionit për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizëm.

Kjo politikë (opsioni 2) mund të parashikojë efekte financiare për operatorë të biznesit ushqimor që importojnë kripë ushqimore. Aktualisht këto subjekte paguajnë një tarifë në vlerën 350 lekë për analizimin e nivelit të jodit në kripën e importuar. Sqarojmë se kjo tarifë është e përcaktuar në urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë të vitit 1998. Me hyrjen në fuqi të projektligjit është e përcaktuar nxjerrja e një udhëzimi të përbashkët me Ministrinë përgjegjëse për Financat lidhur me rishikimin e tarifave të mësipërme. Ende nuk mund të përcaktojmë nëse do të ketë rritje të tarifës apo ulje të saj. Vlerësimi i vendosjes së tarifave do t'i referohet kostove administrative për kryerjen e këtyre analizave.

-Parashikohet të ketë *përfitime ekonomike jo të drejtpërdrejta*(në nivel makroekonomik), sepse me marrjen e masave drejt përcaktimit të rolit të institucioneve në mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës, ndarjen e kompetencave, duke forcuar kështu zbatimin e ligjit për rritjen dhe përmirësimin e standarteve drejt sigurisë, cilësisë së konsumit të kripës, rritet akses i popullatës në kripë të jodizuar dhe marrjen e nevojshme të Jodit; në këtë mënyrë rritet mundësia për parandalimin e çrregullimeve që vijnë prej pamjaftueshmërisë jodike.

Rrjedhimisht sigurohet jeta, shëndeti, rritet produktiviteti i shoqërisë dhe parandalohen kostot e shërbimit shëndetësor dhe të paaftësisë.

“Bazuar në raportin e Copenhagen Consensus 2012- për çdo dollar të shpenzuar në përmirësimin e gjendjes së ushqyerjes së popullatës (ku përfshihet edhe lufta kundër pamjaftueshmërisë jodike) përfitojmë 30 \$ kthim në produktivitetin e shoqërisë.”

Ndikimet Sociale:

- Kjo politikë (opsioni 2) sjell: *Përfitime (efekte) të drejtpërdrejta sociale*: Lidhen me/ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies dhe shëndetit të popullatës.

- *Përfitimet (efektet) jo të drejtpërdrejta sociale*: Lidhen me mbrojtjen e të drejtës së njeriut, si një e drejtë kushtetuese që shtetasit e Republikës së Shqipërisë kanë për të gëzuar në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj politike synohet përmirësimi i sigurisë dhe qëndrueshmërisë të ndërhyrjeve në lidhje me jodizimin universal i cili lidhet me shëndetin publik, duke mundësuar kështu nga shteti një mjedis të shëndetshëm dhe me standartet më të larta shëndetësore, për të siguruar në këtë mënyrë cilësi të jetës në komunitet si dhe garanci në zhvillimin social.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është Opsioni 2: Ndryshimi i ligjit ekzistues.

Ky konsiderohet si opsioni i vetëm që arrin objektivat e politikës, pasi ndryshimet ligjore që propozohen të ndërmerren lidhen me : *mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës*, analizat laboratorike për përcaktimin e nivelit të jodit në mostrën e kripës së jodizuar, në mënyrë që të bëhen sipas rekomandimeve të OBSH, ICCIDD dhe UNICEF; *mirë-përcaktimin konkret të institucioneve përgjegjëse* që do të kryejnë monitorimin dhe inspektimin e kontrollit të kripës së jodizuar, si dhe *ndarjen e qartë të kompetencave* mes strukturave lokale të ISHSH dhe Drejtorive rajonale të shëndetësisë, sa i takon procesit të monitorimit të jodit në kripë dhe një nevojë për bashkëpunim të mirë mes këtyre dy strukturave.

Forcimi i kapaciteteve të personelit përgjigjës për zbatimin e ligjit do të kryhet nëpërmjet trajnimeve që do të mbulohen nga Donatorët.

Donatori do të mbulojë trajnimin e punonjësve që janë të përfshirë në kontroll (monitorim dhe inspektim), punonjës të DRSH, DSHP, ISHSH. Përfituesit do të jenë punonjës që janë pjesë e personelit që merret me kontrollin (monitorimi dhe inspektimi).

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3

KONSULTIMI

Jepni një përmbljedhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përmbushur detyrimin ligjor për ta konsultuar këtë projektligj përmes konsultimeve të hapura në mjediset e ministrisë në date 23 gusht 2018, ku nga pjesëmarrësit nuk pati kundërshtime apo sugjerime.

Gjithashtu projektligji u shpall per konsultim ne faqen elektronike zyrtare të Ministrisë së

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Institucionet që ngarkohen me zbatimin dhe monitorimin e opsionit 2 (të preferuar) janë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ISHP dhe ISHSH të cilët do kryejnë veprimet si më poshtë:

1. Do të vihen në dispozicion institucionet e varësisë me specialistë dhe laboratorët përkatës (DRSH/DSHP) për ushtrimin e kontrolleve në dogana, stabilimentet e jodizimit si dhe në treg (pikat e shumicës dhe pakicës ku tregtohet kripa ushqimore).
2. Monitorimi do të kryhet gjatë gjithë vitit dhe raportimi do të bëhet çdo tre muaj mbi situatën. (Monitorimi në terren).
3. ISHSH do të kryejë inspektime sipas një plani të përcaktuar në subjekte të ndryshme të cilat prodhojnë, importojnë apo tregtojnë kripën ushqimore.
4. Nëse gjatë kontrolleve të ushtruara konstatohen raste të mos respektimit të standardeve të vendosura në ligj dhe aktet nënligjore, ISHSH është përgjegjës për vendosjen e masave administrative sipas rastit.
5. ISHP kryhen studime për vlerësimin e përdorimit të kripës ushqimore të jodizuar në nivel familje dhe matjen e marrjes së jodit në popullatë (joduria).

Gjithashtu çdo subjekt importues, prodhues apo tregtues i kripës ushqimore të jodizuar ka në dispozicion numrat e kontaktit (DRSH, DSHP/ASHR, DRISHSH) për çdo ankesë.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Projektligji është një hap i rëndësishëm në funksion të objektivave sociale, ku shteti brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe përgjegjësisë private *synon standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm. Në këtë kontekst, me këtë politikë synohet përmirësimi i ligjit ekzistues në funksion të arritjes së plotë të mbulimit dhe përmirësimit të cilësisë së kripës së jodizuar në Shqipëri, me disa ndryshime fokusuar në komponentet e kontrollit dhe monitorimit të kripës së jodizuar dhe rolin e institucioneve të përfshira në to, për të ofruar standarte më të mirëmenaxhuara të sistem monitorim-vlerësimit, i cili duke qenë se është thelbësor për sigurimin e suksesit dhe qëndrueshmërisë së programit të fortifikimit të kripës me jod për vendin tonë për të arritur qëllimin final të eliminimit të defiçencës jodike, do të sigurojë ofrimin e garancive dhe standarteve më të larta të mundshme shëndetësore.*

Projektligji lidhet me zbatimin e kontekstit të politikave kombëtare në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2016 – 2020 si dhe misionin e sistemit shëndetësor të Shqipërisë në drejtim të mbrojtjes, përmirësimit dhe promovimit të shëndetit, produktivitetin dhe mirëqenien e të gjithë njerëzve në Shqipëri, duke ofruar shërbime shëndetësore efikase si dhe duke u kujdesur për një progres të qëndrueshëm në shëndetin publik si dhe shëndeti si faktor bazë në çdo politikë, duke adresuar pabarazitë në shëndet për të siguruar shëndet dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e Shqipërisë.

Gjithashtu projektligji lidhet me objektivat e SKZHI (2015-2020) e cila nënvizon rëndësinë e shëndetit si kontribues për zhvillim dhe integrim, si dhe programin e qeverisë i cili fokusohet tek shëndeti si një e mirë publike në drejtim të promovimit të jetës së shëndetshme.

Projektligji është një hap i rëndësishëm për arritjen e objektivave të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në luftën kundër pamjaftueshmërisë jodike me qëllim eliminimin e saj, praktikat dhe ligjshmëritë e të gjitha shteteve, të cilat tashmë e kanë realizuar eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike në vendet e tyre, ku kanë qenë ndërhyrjet drastike në jodizimin universal të kripës, nëpërmjet të cilës realizohet marrja e sasisë së domosdoshme të jodit nga njerëzit dhe kafshët.

Ky projektligji nuk ka për qëllim të përafërohet me legjislacionin e Bashkimit Europian. Megjithatë Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2016-2020 fokusohet ndër të tjera në përputhje me objektivat e SKZHI, ato të Bashkimit Europian, Politikat Kuadër të OBSH për shëndet dhe mirëqenie “Shëndet 2020”, Angazhimet Kombëtare për Axiendën 2030, objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe partneritetet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare rajonale për shëndetësinë.

Për më tepër, zbatimi i jodizimit universal të kripës është strategjia e rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe UNICEF për parandalimin e pamjaftueshmërisë jodike. Në vitin 2013, Asambleja e Organizatës Botërore të Shëndetit ritheksoi faktin që lufta kundër pamjaftueshmërisë jodike kontribuon direkt në arritjen e disa objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit, përfshirë, luftën kundër varfërisë, reduktimin e vdekshmërisë femërore, shëndetin e nënës, arsimin për të gjithë, dhe barazinë gjinore.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Aktualisht ka probleme në zbatimin e ligjit, i cili synon parandalimin e çrregullimeve që vijnë nga pamjaftueshmëria jodike me një sistem masash që merren për të përmbushur nevojën fiziologjike të organizmit për jod.

Natyra e problemit lidhet me mënyrën e kryerjes së kontrollit (inspektim dhe monitorim) të kripës së jodizuar dhe rolin e institucioneve, ku aktualisht mungojnë si të papërcaktuar në ligj, mekanizmat institucional monitorues.

Roli i institucioneve të përfshira aktualisht në *komponentët e kontrollit (inspektimit dhe monitorimit) të kripës së jodizuar është i paqartë në drejtim të: përcaktimit të institucioneve që do të bëjnë monitorimin dhe inspektimin e kripës së jodizuar, ndarjen e qartë të kompetencave të çdo institucioni dhe ndarjen e qartë të kompetencave të strukturave që do të bëjnë konkretisht procesin e monitorimit.*

Në këtë situatë mbetet problem dhe është konfuz fakti se si do të arrihet të matet zbatimi i detyrimeve ligjore/detyrimeve të dhëna me ligj të çdo institucioni; pra zbatimi korrekt i ligjit për sigurinë, cilësinë e kripës së jodizuar, elementë të cilët ndikojnë në shëndet, e rrjedhimisht në mirëqenien e popullatës.

Me ndryshimet ligjore të vitit 2013 që prekën rolet e institucioneve aktuale si ato që lidhen me ndryshimet në Strukturën Kombëtare të Menaxhimit (krijimi i Inspektoriatit Shtetëror të Shëndetësisë), lindën probleme në zbatimin e ligjit, në drejtim të kontrollit dhe monitorimit të

kripës së jodizuar duke lënë të papërcaktuar dhe mungesë në legjislacion të mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit institucional.

Në mungesë të një kuadri institucional të qëndrueshëm e të përcaktuar, me ndarje të qartë të kompetencave për mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës, është konstatuar se:

Në operatorët e biznesit ushqimor, ku rezulton se ka ndryshim të raportit import-prodhim vendas:

- *Ndryshimet sasiore në burimet e furnizimit me kripë të jodizuar në vend (pjesa më e madhe e kripës, rreth 75%, në treg gjatë viteve të fundit sigurohet nga prodhuesit vendas të kripës së jodizuar në krahasim me importet që mbizotëronin në vitet e mëparshme).*

Deri në vitin 2012 pjesa më e madhe e kripës së jodizuar sigurohej nga importi. Me ngritjen në vend të disa stabilimenteve të jodizimit si në Durrës, Rrogozhinë, etj ka një rritje të konsiderueshme të prodhimit vendas të kripës së jodizuar (për 2017 kjo shifër kap vlerën 8198 ton) dhe rënie vit pas viti të kripës së jodizuar të importuar. Lënda e parë për këto stabilimente sigurohej nga importi;

Si dhe rezulton se ka hezitim në përdorimin vetëm të kripës së jodizuar si në nivel familjeje edhe në industrinë ushqimore prej:

- Perceptimit të gabuar të efekteve negative të jodit në produktet që ata prodhojnë (lidhur me konsistencën, qëndrueshmërinë kohore të produktit, etj) nga disa grupe të veçanta të përpunuesve të ushqimit në përdorimin e kripës ushqimore së jodizuar;
- Prania ende në treg e (hequr edhe)kripës së pajodizuar për destinacion konsumin njerëzor, shtazor dhe industrinë ushqimore;

Tek popullata, ku rezulton ende një pjesë e popullatës me marrje të mangëta të jodit nëpërmjet ushqimit, duke vuajtur kështu nga kequshqyerja në mikronutriente:

- *Situata në nivel kombëtar e marrjeve akoma të mangëta ushqimore të jodit të popullsisë shqiptare (studimi i fundit kombëtar-viti 2012- i Vlerësimit të gjendjes jodike në popullatën shqiptare me anë të matjes së dy indikatorëve: treguesit të jodurisë dhe nivelit të jodit në kripën ushqimore, tregoi se ende rreth 50% e popullatës ka mangësi në jod dhe 38% e popullatës përdor kripë të pajodizuar në mënyrën e duhur).*

Studimet kanë treguar se mënyra më e mirë për të marrë jodin është nëpërmjet ushqimeve të pasura natyralisht me jod. Ushqime të tilla janë kryesisht bulmeti, prodhimet e detit, e më pak veza, mishi, disa fruta dhe perime. Megjithatë ka edhe disa ushqime të cilat pengojnë thithjen e jodit nga trupi ynë duke shërbyer si burim në shfaqjen e sëmundjeve prej mungesës së jodit.

Lidhur me marrjen e ushqimeve të mangëta me jod mund të ketë shumë shkaqe si (shkaqet që lidhen me faktorë të brendshëm socialë) si: varfëria dhe niveli ekonomik i ndryshëm i jetesës së individëve, mungesa e mundësisë për të marrë ushqime të shumëllojshme, mungesa e njohurive mbi praktikën e përshtatshme të ushqyerjes, marrjet e pakëta nga dietat ushqimore, etj.

Shkaku (kryesor): Qasja ende e një pjese të popullatës shqiptare për kripë të pajodizuar, dhe përdorimi i saj si në nivel familjeje edhe nga operatorë të biznesit ushqimor bën të pranishme

pamjaftueshmërinë jodike në Shqipëri si në çështje të rëndësishme të shëndetit publik (më shumë se 20% e popullatës).

Pavarësisht faktorëve socialë, e rëndësishme është fakti se sot vijon të ketë qasje për kripë ushqimore të pajodizuar, që sjell mangësi në marrjen e jodit nëpërmjet ushqimit. Kjo situatë evidenton problemin lidhur me zbatimin e ligjit për sa i përket mënyrës së kryerjes së kontrollit të kripës në drejtim të eliminimit dhe parandalimit të çrregullimeve që vijnë nga pamjaftueshmëria jodike.

Pasojat e dëmtimit të shëndetit që mund të vijnë tek njerëzit janë:

Tek të rriturit shkakton: dobësi; lodhje të shpejtë; ulje e aftësisë për të punuar; ulje të aftësisë për t'u kujdesur për familjen dhe për veten; ulje të inteligjencës; gushë, e cila ndonëse një problem shqetësues estetik, është në vetvete një problem real shëndetësor. “Gusha” përbën zmadhim të gjendrës tiroide që ndodhet në pjesën e përparme të qafës dhe kur mungon jodi kjo gjendër përpiqet ta përballojë këtë duke u zmadhuar për të kapur sa më tepër jod. “Gusha” është pasoja më e dukshme e mungesës së jodit në trupin e njeriut.

Tek gratë shtatzëna shkakton: dështime; lindje parakohe; fëmijë të lindur vdekur; fëmijë të lindur me peshë të ulët dhe me pak shanse për të jetuar; fëmijë të lindur me deformime.

Gratë shtatzëna dhe fëmijët e vegjël kanë më shumë nevojë se të tjerët për jod për një zhvillim normal të trurit dhe trupit të fëmijës. Për foshnjat burimi i vetëm i jodit është nëna. Nënata që ushqejnë fëmijët e tyre me gji janë burimi i vetëm dhe i mjaftueshëm jodi për foshnjën nëse marrim jodin në sasi të mjaftueshme.

Tek fëmija shkakton: vonesë në zhvillimin e trupit- fëmijë shtatshkurtër-xhuxh; defekte në të folur e të dëgjuar- shurdh-memec; paraliza; tek fëmijet e shkollës -ulje të përqëndrimit, vështirësi për të mësuar, ngathtësi, dobësi fizike.

Pamjaftueshmëria jodike është shkak më i zakonshëm i prapambetjes mendore e parandalueshme, duke ndikuar në aftësinë e të nxëniet të fëmijëve dhe produktivitetin në moshën adulte (vonesë në zhvillimin e trurit-fëmijë me të meta mendore). Studime të shumta kanë evidentuar ndikimin e marrjeve të mangëta të jodit tek fëmijët, të shoqëruara me një ulje të koeficientit të inteligjencës në 13 pikë në raport me fëmijët me marrje të mjaftueshme të jodit.

Mungesa e jodit jep dëmtime për të gjithë jetën tek truri dhe trupi i fëmijes.

Dëmtime të tjera shumë serioze që shkaktohen prej mungesës së jodit është **kretinizmi** (forma më serioze e dëmtimeve të trurit), që përbën rastin tipik të pamjaftueshmërisë së rëndë jodike dhe të sëmurët njihen si *persona me prapambetje mendore*.

Përben fakt, se një fëmijë i prekur nga kretinizmi nuk mund të ecë, nuk mund të flasë dhe nuk mund të mendojë normalisht.

Tek kafshët: Mungesa e sasisë së jodit tek kafshët/bagëtitë të cilat ushqehen me kripë të jodizuar ndikojnë në aftësinë e tyre për të gjenuar prodhimtarinë (shterpë) për të cilën ka nevojë njeriu dhe shoqëria.

Problematikat që dalin në zbatimin e ligjit aktual, në drejtim të mënyrës së kryerjes së kontrollit në kripën e jodizuar, si dhe qasjes jo të plotë të popullatës për konsum të kripës së jodizuar me ndikim në shëndet, problemeve në shëndet/dhe në termat ku rëndësia e mbrojtjes së shëndetit publik i referohet një target grupi të gjerë gjithpërfshirës-fokusi-popullata, të gjitha këto pengojnë në zhvillimin e shëndetit (një e mirë publike), si kontribues për zhvillim dhe integrim, në funksion të **objektivave të qeverisë**.

Gjithashtu problematikat me zbatimin e ligjit, në drejtim të mënyrës së kryerjes së kontrollit në kripën e jodizuar, në mungesë të një kuadri institucional me kompetenca të ndara që masin zbatimin konkret të ligjit dhe kur akses i popullatës në kripë të jodizuar është jo i plotë, me ndikim në shëndet, shoqërohet gjithashtu me pengesa në zhvillimin dhe **mirëqenien e gjithë shoqërisë**, ulje të produktivitetit ekonomik, social.

Po ashtu problematikat që dalin në zbatimin e ligjit, në drejtim të mënyrës së kryerjes së kontrollit në kripën e jodizuar dhe rolin e institucioneve, ku për shkak se aktualisht mungojnë dhe janë të papërcaktuar në ligj mekanizmat institucional kontrollues dhe monitorues, çojnë në domosdoshmërinë që për të trajtuar këtë problem të bëhen disa ndryshime në ligjin aktual fokusuar në komponentët *e inspektimit dhe monitorimit të kripës së jodizuar*, për përcaktimin e institucioneve që do të bëjnë monitorimin dhe inspektimin **e kontrollit** të kripës së jodizuar, ndarjen e qartë të kompetencave dhe dhënien kompetencave strukturate institucionale për procesin e monitorimit, duke shmangur mbivendosjet dhe plotësuar boshllëqet që ekzistojnë aktualisht.

Më konkretisht:

Prania ende e kripës së pajodizuar në treg me burim prej stabilimenteve të jodizimit në vend, apo prej importit që më pas tregtohet në vend, e cila shoqërohet me marrjen e mangët të jodit nëpërmjet ushqimit (kripa) nga popullata, dikton si të nevojshme se duhet të ndërhyet në mënyrë që të garantohet qasja vetëm për kripë ushqimore të jodizuar, faktor që ndikon në shëndetin e mirëqenien e popullatës.

Sigurimi i qasjes së popullsisë në vend me kripë të jodizuar, nuk mund të garantohet pa përcaktuar një kuadër të qendrueshëm institucional, e më konkretisht pa përcaktuar institucionet që do të bëjnë inspektimin, monitorimin e kontrollit të kripës së jodizuar (mënyra e kryerjes së kontrollit të kripës).

Prandaj, vlerësohet e nevojshme me këtë politikë të ndërhyet për të trajtuar problemin aktual, si dhe të **përmirësohet e forcohet zbatimi i ligjit** për arritjen e konsumit nga e gjithë popullata vetëm të kripës së jodizuar, *me synim përfundimtar arritjen e mjaftueshmërisë jodike në Shqipëri*, duke qenë se qëllimi kryesor është parandalimi nëpërmjet një sistem masash për të përmbushur nevojën fiziologjike të organizmit me jod.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

1. Nëpërmjet kësaj politike planifikohet të ndërhyet për të përmirësuar dhe forcuar zbatimin e ligjit për rritjen dhe përmirësimin e standarteve për konsumin e kripës së jodizuar

2. Justifikohet ndërhyrja për të trajtuar dështimin rregullator: Problematikat mbi rolin e institucioneve, kanë sjell problem në zbatimin e ligjit.

‘Dështimi rregullator’-

Shkaku kryesor i problemeve në zbatimin e ligjit, lidhen me ndryshimet ligjore të vitit 2013 që preken rolet e institucioneve aktuale, në drejtim të kontrollit të kripës së jodizuar duke lënë të papërcaktuar dhe mungesë në legjislacion të mekanizmave të monitorimit institucional.

Ndërhyrja e qeverisë është e justifikuar sepse nëse nuk ndërhyet, apo nëse nuk merren masa që me ligj të përcaktohen institucionet e kontrollit të kripës dhe ndarjen e qartë të kompetencave rezulton se:

- mbetet konfuz fakti si mund të matet zbatimi i ligjit, që synon parandalim;
- mbetet e paqartë si mund të maten zbatimi i detyrimeve të dhëna me ligj të institucioneve të përfshira në mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës, në sigurinë, cilësinë dhe standartet e kripës së jodizuar, të cilat ndikojnë në rezultatin e dëshiruar: përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenien e popullatës, e lidhur ngushtësisht me faktin se sot vijojmë të kemi marrje të mangëta të jodit nëpërmjet ushqimit.

Sot përbën fakt se:

- *Kequshqyerja nga mungesa e Jodit*, është një nga barrierat **për zhvillimin socio-ekonomik**, duke kontribuar në krijimin e një rrethi vicioz, i cili pengon zhvillimin dhe dëmton grupet që janë aktualisht në pozita të pafavorshme. Sidomos gratë shtatzëna dhe fëmijët e vegjël, pasi ato ndikojnë në rritjen e fetusit dhe fëmijës, zhvillimin e intelektit.
- Ajo ka **efekte afat-gjatë në shëndet**, në aftësinë dhe produktivitetin e të mësuarit si dhe ka kosto të lartë shoqërore dhe publike, që çon në kapacitet të reduktuar për punë për shkak të nivelit të lartë të sëmundshmërisë dhe paaftësisë. Tashmë është e njohur se efektet e mungesës së jodit në zhvillimin e trurit përbëjnë një kërcënim për zhvillimin social dhe ekonomik të shumë vendeve.

*Fortifikimi i ushqimeve me vitamina dhe minerale mund të jetë një mënyrë efektive për të luftuar pamjaftueshmërinë e mikronutrientëve, (në rastin tonë të jodit). Ai konsiderohet si një nga mjetet më kosto-efektive për korrigjimin e kequshqyerjes nga mikronutrientët (Banka Botërore 1994). Bazuar në raportin e Copenhagen Consensus 2012- për çdo dollar të shpenzuar në përmirësimin e gjendjes së ushqyerjes së popullatës (ku përfshihet edhe lufta kundër pamjaftueshmërisë jodike) përfitojmë 30 \$ kthim në produktivitetin e shoqërisë.

3. Legjislacioni dhe kuadri rregullator kryesor i zhvilluar gjatë kësaj kohe për të arritur ushqyerjen optimale me jod përfshin:

- **Ndërhyrje afatshkurtër me kapsula jodi (1996);**

Krahasuar me kripën e jodizuar, përdorimi i kapsulave vajore të jodit është më i shtrenjtë dhe shpërndarja e tyre mund të jetë e vështirë sepse kërkon kontakt të drejtpërdrejtë me çdo person.

Rrjedhimisht, kjo metodë referuar edhe nga praktikrat e ndjekura në botë, rekomandohet vetëm për popullatat që jetojnë në zonat endemike me deficiencë të rëndë dhe ku nuk ka qasje në kripë të jodizuar.

Ndaj mbetet zgjidhja optimale: Futja në shkallë të gjerë të përdorimit të kripës së jodizuar.

- **Krijimin e Komitetit Kombëtar për Eliminimin e Pamjaftueshmërisë Jodike (1997);**
- **VKM për fortifikimin e kripës së tryezës (Vendim nr.549, datë 27.11.1997 “Për importimin e kripës së gjellës së jodizuar dhe prodhimin e saj në vend);**

Për herë të parë u përcaktuan standartet kombëtare mbi nivelet e jodit në kripë. Ndonëse ky akt nënligjor ishte një hap shumë i rëndësishëm për kohën, përvoja e viteve të mëvonshme tregoi se nëpërmjet saj, nuk mund të realizohej eliminimi i deficiencës jodike si tek njerëzit dhe tek kafshët.

- Ligji nr.9942, datë 26.6.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”), e ndjekur nga Udhëzimi i përbashkët midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave “Për bashkëpunim në kontrollin e kripës ushqimore të jodizuar që importohet për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore” Rregullore e

përbashkët midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit “Për etiketimin, ambalazhimin dhe kushtet ruajtjes së kripës së jodizuar për konsum human dhe shtazor”, Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë “Për përcaktimin e institucioneve shëndetësore, që do të kryejnë analizat, për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën e jodizuar”.

Ky ligj ishte i rëndësishëm për krijimin e një kuadri ligjor të nevojshëm për jodizimin universal të kripës për përdorim human, shtazor dhe industrinë ushqimore. Ai realizonte të gjithë gamën e veprimtarive që nga importi, prodhimi dhe deri tek konsumatori, duke realizuar që njeriu në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe të tërthortë të konsumojë vetëm kripë të jodizuar.

- **Ngritja dhe funksionimi i Sistemit Kombëtar për Monitorimin e Cilësisë së Kripës së Jodizuar sipas niveleve;**
- **Vlerësimi i vazhdueshëm i progresit përeleminimin e pamjaftueshmërisë jodike në Shqipëri pas futjes së kripës së jodizuar.**

4. Ndërhyrja e qeverisë justifikohet nga problematikat e hasura si më poshtë:

Sipas studimeve dhe vlerësimeve të kryera rezulton se pavarësisht përmirësimeve të realizuara, kanë dalë disa problematika në zbatimin e legjislacionit aktual të vitit 2008 dhe me ndryshimet e vitit 2013, lidhur me monitorimin e nivelit të jodit të kripës, me sigurinë dhe cilësinë e kripës së jodizuar, duke shtuar edhe faktin se popullata shqiptare nuk e ka eliminuar plotësisht deficencën jodike.

Pamjaftueshmëria jodike është evidentuar si problem edhe gjatë analizës së ecurisë dhe situatës aktuale të gjendjes nutricionalë të jodit në popullatën shqiptare nga Komiteti Kombëtar për Eliminimin e Çrregullimeve nga pamjaftueshmëria, ku rezulton se pamjaftueshmëria jodike mbetet ende e pranishme, ndaj Komiteti arriti në konkluzionin se është e nevojshme të rishikohet kuadri ligjor në funksion të arritjes së plotë të mbulimit dhe përmirësimit të cilësisë së kripës së jodizuar në Shqipëri.

Problemet gjatë zbatimit të ligjit aktual për kontrollin e kripës së jodizuar janë si më poshtë vijon:

Procesi i kontrollit të kripës së jodizuar me institucionet përgjegjëse përkatëse, përbëjnë mekanizmin kryesor në mënyrë që të arrihet rezultati dhe qëllimi i ligjvënësit drejt **jodizimit të përgjithshëm si dhe eliminimit të pamjaftueshmërisë jodike.**

- Me ligjin e vitit 2008, *kontrolli i kripës së jodizuar (e prodhuar ose e importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë), bëhet prej Inspektoriatit Sanitar Shtetëror.*

Me ndryshimet ligjore të vitit 2013, konkretisht me Ligjin nr.54/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9942, datë 26.6.2008 Për Parandalimin e Çrregullimeve Jodike të shkaktuara nga Pamjaftueshmëria e Jodit në Organizmin e Njeriut”, emërtimi “Inspektoriat Sanitar Shtetëror” zëvendësohet me emërtimin “Inspektoriat që mbulon fushën e shëndetit”.

Në dispozitën tranzitore parashikohet se organi ekzistues inspektues (pra Insp.Sanitar Shtetëror) do të kryejë detyrën e inspektimit deri në krijimin e organit të ri.

Sipas përcaktimeve ligjore të vitit 2013, rezulton se inspektimi për verifikimin e kërkesave ligjore që burojnë prej *Ligjit të v.2008* dhe atyre sipas *Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011* “Për Inspektimin në RSH”, do të jetë përgjegjësi e ISHSH.

Me VKM nr.241, dt.27.3.2013 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor”, përcaktohet se ISHSH ka për mision garantimin dhe respektimin e kërkesave

ligjore në fushën e shëndetit publik, dhe se është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit në fushën farmaceutike.

Sa më sipër **procesi i inspektimit** konsiston në verifikimin e veprimtarisë të subjektit të inspektuar, nëse është në përputhje me kërkesat ligjore, nxjerrje përfundimesh të nevojshme deri në dhënien e sanksioneve të mundshme administrative (sipas ligjit të inspektimit) dhe inspektim i kërkesave të cilësisë dhe sigurisë sipas legjislacionit të v.2008.)

- Monitorimi është mbledhja rutinë dhe analiza e informacionit për të përcjellë progresin ndaj planeve të caktuara dhe për të kontrolluar pajtueshmërinë e standardeve të përcaktuara nëpërmjet kryerjes së analizave laboratorike dhe me kite në terren për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën e jodizuar.

Nga rezultatet e procesit të monitorimit bëhet *vlerësimi i situatës*, duke ofruar një mundësi për të vlerësuar edhe shkallën e përfshirjes së familjeve dhe individëve target, si dhe arritjen e objektivave të ushqyerjes.

Më e rëndësishmja është se **rezultatet e monitorimit dhe vlerësimi të jodit** i pajisin planifikuesit e programeve dhe vendim-marrësit me **informacionin e nevojshëm** për të **marrë vendime** në lidhje me vazhdimësinë, zgjerimin, përsëritjen apo përbushjen e objektivit për eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike në popullatën shqiptare.

Me ndryshimet ligjore të vitit 2013, ISHSH, për shkak se fusha e veprimtarisë ndryshoi, doli jashtë varësisë së DRSH dhe DSHP, dhe u krijua si institucion më vete qëndror, buxhetor në varësi të Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë dhe duke pasur kështu mision vetëm inspektimin (sipas një plani të mirëpërcaktuar; me njoftim të subjektit që inspektohet), dhe jo monitorimin.

Pra heqja e të drejtës së marrjes se mostrës, u bë indirekt me përcaktimin e detyrave të ISHSH sipas legjislacionit të vitit 2013.

Problematikat që dolën lidhur me procesin e monitorimit, ishin pikërisht me marrjen e mostrës së kripës së jodizuar në terren, për faktin se tashmë fusha e ISHSH ndryshoi, dhe monitorimi nuk ishte më detyrim i tij.

Në një stiutate të tillë ku ‘monitorimi’ mbeti si proces i pambuluar/i papërcaktuar në ligj, diktoi nevojën faktike që institucionet shëndetësore që dikur merrnin mostrën në terren (DRSH, DSHP) të bashkëpunonin me ISHSH për mbulimin deri diku të kësaj situate.

Në DSHP dhe DRSH, aktualisht, **referuar rregulloreve të veprimtarisë së tyre** dhe strukturave përkthënë të miratuara, gjenden të atashuar laboratorët e shëndetit publik. Ekzistojnë specialistët e fushës si laborantë mjekësorë, bakterologë, laborantë kimistë, higjenistë të cilët merren me përpunimin e të dhënave dhe analizave. Këta specialistë interpretojnë dhe nxjerrin konkluzionet. Këto të dhëna, mund t’u përcillen institucioneve që kanë nevojë për informacion, prej titullarit të DRSH, DSHP.

Në këtë mënyrë, DRSH dhe DSHP bëjnë vlerësim përfundimtar me ekspertë, duke përpunuar informacion.

ISHSH, si organ administrativ, ka për detyrë **vetëm inspektime**, konstatim në terren, dhe të drejtën për të shprehur një akt-konstatimi përkatës në vendngjarje.

*Si më sipër, në situatën ku procesi i monitorimit mbetet pa një përcaktim ligjor konkret për faktin se cilit institucion i atribuohet kjo kompetencë me ligj, rezulton e domosdoshme që të përcaktohen (në ligj) institucionet që do të kryejnë monitorimin e kripës së jodizuar, si dhe, të ndahen qartë kompetencat mes strukturave të ISHSH dhe DRSH, DSHP për procesin e kontrollit.

- Për sa i përket *kontrolleve në pikat doganore të kripës së importuar*, me legjislacionin aktual të vitit 2008, në nenin 13 parashikohet se “Në rastet kur kripa e jodizuar importohet, verifikimi dhe vlerësimi i dokumentave shoqëruese të saj në pikat e kalimit kufitar janë të detyrueshëm dhe kryhen nga përfaqësuesit e Inspektoriatit Sanitar Shtetëror, dhe ata të doganës, brenda kompetencave përkatëse”.

*Sipas argumentimeve më sipër për krijimin e ISHSH, lind e nevojshme të ndërhyet dhe të përcaktohen institucionet që do bëjnë kontrollin (inspektimin dhe monitorimin) e kripës së importuar, në pikat e kalimit kufitar.

Shkalla e ndërhyrjes si më sipër analizuar është:

- Referuar analizës së deritanishme dhe identifikimit të **boshllëqeve** në Ligjin nr.9942, datë 26.6.2008, i ndryshuar, shihet e nevojshme ndërhyrja e qeverisë për përditësimin e këtij ligji me disa ndryshime pikërisht në komponentet e kontrollit të kripës së jodizuar, konkretisht për mënyrën e kryerjes së monitorimit të kripës.

Së pari: Kjo politikë **qartëson dhe përcakton se kontrolli i kripës së jodizuar**, si në rastin kur ajo prodhohet në vend ashtu edhe kur importohet, e destinuar për tregtim në Shqipëri **përfshin dy veprimtari:** “monitorim” dhe “inspektim”.

Së dyti: Kjo politikë **përcakton institucionet** që do të bëjnë monitorimin dhe inspektimin e kontrollit të kripës së jodizuar. Konkretisht institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre përkatëse do të jenë:

- Monitorimi kryhet nga Drejtoritë Rajonale dhe Vendore të Shëndetësisë brenda juridiksionit të tyre;

-Inspektimi kryhet nga Inspektoriatit që mbulon fushën e shëndetësisë (ISHSH).

Së treti: Për **kontrollin e kripës ushqimore të jodizuar që importohet** në Republikën e Shqipërisë, me një dispozitë të re parashikohen organet përgjegjëse, ku propozohet se:

“Kripa e jodizuar që importohet në Republikën e Shqipërisë nga subjektet importues i nënshtrohet kontrollit në pikat doganore (Degët Doganore Kufitare). Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor, Drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë brenda juridiksionit të tyre dhe Inspektoriatit që mbulon fushën e shëndetësisë”.

Përfshirja e ISHSH në kontrollin e pikave doganore, do të lidhet me verifikimin e kërkesave ligjore që duhet të respektohen prej importuesit, si dhe është në shprehje të asaj që parashikon kjo politikë me ndryshimet ligjore duke përcaktuar se aktiviteti “inspektim” përbën një prej veprimtarive të kontrollit të kripës së jodizuar ose të importuar.

Përfshirja e DRSH dhe DSHP referuar termit “kontroll”, do të jetë për të kryer monitorimin, për shkak të mjeteve reale që disponojnë këto institucione me laboratorët përkatës dhe specialistët e fushës.

Përfshirja e përfaqësuesit të Autoritetit Doganor është për shkak të ushtrimit të detyrës funksionale prej tij në pikat e kalimit doganor.

Në këtë mënyrë **përcaktohen institucionet për kontrollin e kripës**, ndahen qartë kompetencat mes ISHSH dhe DRSH, DSHP.

Ndarja e kompetencave dhe përcaktimi i institucioneve, bën që me ligj **të jepet konkretisht kompetenca e monitorimit institucionit përkatës**, ku deri më sot DRSH, DSHP nuk kanë **pasur kompetencën si atribut-e drejtë-detyrim që rrjedh nga ligji**, për shkak se procesi i monitorimit, si më sipërshejguar nuk ka pasur një përcaktim (ligjor) që të reflektonte ndryshimet ligjore që prekën rolin e institucioneve aktuale.

Këto ndryshime synojnë të **mirë-specifikojnë institucionet e përfshira në monitorimin, inspektimin e kontrollit dhe vlerësimin e kripës së jodizuar, si dhe mirë-përcaktojnë detyrimet e gjithsecilit institucion duke shmangur mbivendosjet apo boshllëqet e konstatuara deri tani.**

- Kjo ndërhyrje e qeverisë do të mund të sigurojë një sistem **monitorim vlerësimi** më të **mirëmenaxhuar**, i cili është thelbësor për sigurimin e suksesit dhe qëndrueshmërisë së programit të fortifikimit të kripës me jod për vendin tone (në kuadër të jodizimit të përgjithshëm të kripës), në drejtim të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit publik.¹

Monitorimi do të kryhet prej DRSH dhe DSHP, sepse :

- a.Me infrastrukturën laboratorike që disponojnë, këto institucione mund të kryejnë analiza laboratorike;
- b. Me specialistët e mirëfilltë shëndetësorë që kanë të punësuar (si bakterologë; higjienistë; kimistë; etj) mund të përpunojnë të dhëna dhe analizat.
- c. Interpretojnë dhe nxjerrin konkluzione në bazë të analizave të kryera, kryejnë vlerësimin përfundimtar me ekspertët dhe përpunojnë informacionin përkatës.
- ç. Raportojnë tek organi epror si dhe përcjellin informacion që vjen prej intepretimit dhe nxjerrjes së konkluzioneve prej të dhënave nga analizat laboratorike.

Në këtë mënyrë vlerësohet cilësia e zbatimit të ndërhyrjes të fortifikimit të kripës me jod, qëndrueshmëria e saj si dhe parandalimi; me synim të eliminohen çrregullimet që vijnë prej pamjaftueshmërisë jodike.

- Politika e vitit 2018 synon **ndarjen e qartë të roleve të institucioneve përgjegjëse** ashtu **edhe fuqizimin e tyre, pasi konkretisht:**

Drejtoritë Rajonale dhe Vendore të Shëndetësisë, do të kenë një kontribut të shtuar drejt **monitorimit të nivelit të jodit** në kripën e jodizuar si në pikat e prodhimit **në vend** në pikat e shitjes me shumicë/pakicë; si dhe në rastin e importimit të kripës së jodizuar në pikat doganore brenda juridiksionit të tyre.

Shëndeti si një e mirë publike

Shëndeti si një e mirë publike, është një kontribues për zhvillim dhe integrim, dhe investimi në përmirësimin e tij, rrit produktivitetin dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve në Shqipëri.

Me ndërhyrjen që parashikon kjo politikë ku ndryshimet ligjore lidhen me mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës duke përcaktuar institucionet që do bëjnë monitorimin, inspektimin e kontrollit të kripës, ndarjen dhe dhënien e kompetencave për të shmangur mbivendosjet, trajtohet problemi i evidentuar, dhe përmirësohet e forcohet zbatimi i ligjit (i cili synon parandalimin), në drejtim të sigurisë, cilësisë, arritjes të standarteve në konsumin e kripës së jodizuar.

Kriteret mbi sigurinë dhe cilësinë, si dhe ndalimi kategorik për importim, prodhim, tregtim apo reklamim të *kripës së pajodizuar* ose jashtë standartit të mirëpërcaktuara në

¹ Rasti kur: lidhur me procesin e monitorimit përpunohen të dhënat prej analizave, vlerësimi i tyre dhe përcjellja e këtij informacioni si dhe raportimi në organin epror.

legjislacionin aktual të cilat lidhen me: nivelet e jodizimit që duhet të ketë kripa e jodizuar që prodhohet në vend, nivelet e jodizimit të kripës së jodizuar që importohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, nivelet e jodizimit të kripës që tregtohet; kriteret lidhur me ambalazhimin dhe etiketimin-emërtimit të produktit “kripë e jodizuar”; respektimi i afateve të skadencës.

Këto kriteret të sigurisë dhe cilësisë mbeten të pandryshueshme, dhe shërbejnë si indikator matës drejt respektimit ose jo të kërkesave ligjore, me synimin: parandalimin deri në eliminimin përfundimtar të çrregullimeve që vijnë prej pamjaftueshmërisë jodike e cila vijon të jetë prezent.

Nëpërmjet ndërhyrjes me këtë politikë, duke përcaktuar një kuadër institucional me detyra të qarta përsa i përket forcimit të zbatimit të ligjit, rritet mundësia për reduktimin e kripës së pajodizuar apo jashtë standarteve. Me reduktimin, do të rritet aksesimi i popullatës për konsum të kripës brenda standarteve. Në këtë mënyrë forcohet parandalimi dhe ullet probabiliteti për çrregullimet që vijnë prej pamjaftueshmërisë jodike, e cila ndikon në shëndet e rrjedhimisht në mirëqenien e popullatës.

Në këtë mënyrë nëpërmjet kontrollit të cilësisë, sigurisë, dhe arritjes të standarteve, investohet në përmirësimin e shëndetit-si një e mirë publike-duke u rritur mundësia që të merret sasia e nevojshme e jodit për organizmin, mungesa e të cilit sjell çrregullime fizike, psiqike.

–Në këtë kontest, me këtë politikë e cila synon përmirësimin e ligjit ekzistues në funksion të arritjes së plotë të mbulimit dhe përmirësimit të cilësisë së kripës së jodizuar në Shqipëri, me disa ndryshime fokusuar në komponentet e kontrollit kripës së jodizuar dhe rolin e institucioneve të përfshira në to, nëpërmjet kontrollit të cilësisë, sigurisë, dhe arritjes të standarteve.

Projektligji është një hap i rëndësishëm në funksion të objektivave sociale, ku shteti brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe mjeteve që disponon si dhe në plotësim të nismës dhe përgjegjësisë private synon standartin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm. Zbatimi i jodizimit universal të kripës është strategjia e rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe UNICEF për parandalimin e pamjaftueshmërisë jodike, për faktin se lufta kundër pamjaftueshmërisë jodike kontribuon direkt në arritjen e disa objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit, përfshirë, luftën kundër varfërisë, reduktimin e vdekshmërisë femërore, shëndetin e nënës, arsimin për të gjithë, dhe barazinë gjinore.

Objektivi i politikës

- Vendosi objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.
- Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe në kohë.

Politika synon të arrijë rezultatet e mëposhtme:

1. Të kontrollohet në masën 100 % kripa ushqimore e prodhuar nga stabilimentet e jodizimit të kripës ushqimore në Republikën e Shqipërisë;

Politika me ndryshimet e reja ligjore synon që të arrijë rezultatin që stabilimentet e jodit në RSH, të kontrollohen për të mos nxjerrë në treg kripë jashtë standarteve ligjore; (duke qenë se ende në treg vijon të ketë kripë të pajodizuar prej operatorit të biznesit ushqimor).

2. Të kontrollohet në masën 100 % kripa ushqimore e importuar në Republikën e Shqipërisë përmes marrjes në kohë të mostrës dhe analizës laboratorike për nivelin e jodit, në çastin e futjes së kripës në pikat doganore në RSH.

Politika me ndryshimet ligjore synon të mos kalojë në doganë kripa që është në mospërputhje me standartet e ligjit.

Kjo do të bëhet nëpërmjet ndarjes së qartë të kompetencave për sa i përket procesit të monitorimit mes strukturave ISHS, DRS, DSHP.

3. Të monitorohet në masën 100 % të mbulimit të territorit të vendit, niveli i përmbajtjes së jodit në kripën ushqimore, bazuar në zbatimin e një metodologjie kampionimi përfaqësuese të të dhënave në nivel kombëtar sipas planifikimit vjetor të monitorimit nga strukturat vartëse të MSHMS në nivel kombëtar dhe rajonal.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni i status quo-së –

Në kushtet e zbatimit të ligjit aktual, me ndryshimet ligjore të vitit 2013 që prekën rolin e institucioneve aktuale në drejtim të monitorimit, lindi një problematikë **ku mbetet të papërcaktuara në legjislacion mekanizmat e kontrollit institucional.**

Me situatën aktuale nëse nuk ndërhyjmë me rregullime ligjore, atëherë mbetet i paqartë si dhe konfuz fakti se si mund të arrihet të matet zbatimi i detyrimeve ligjore të çdo institucioni në drejtim të kontrollit të sigurisë, cilësisë, standartave, me ndikim në shëndetin publik.

Opsioni 1: Miratimi i një ligji të ri

Përsa i përket Opsionit 1, miratimit të një ligji të ri si model zbatimi, edhe ky opsion nuk do të zgjidhte situatën aktuale, pasi bazat e kriterëve dhe kërkesave ligjore themelore janë tashmë të sanksionuara në ligj, të cilat janë të matura referuar kushteve të popullatës shqiptare.

Opsioni 2: Ndryshimi i Ligjit Ekzistues

Ky konsiderohet si opsioni i vetëm që arrin objektivat e politikës ligjërish, pasi me ndryshimet ligjore që propozohen të ndërmerren në përcaktimin e institucioneve të kontrollit të kripës, ndarjen e qartë të kompetencave, **synohet të përmirësohet dhe forcohet zbatimi i ligjit për arritjen e standarteve për konsumin e kripës së jodizuar.**

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*

- o Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.

- **Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:**

- o Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
- o Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
- o Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Për efekt të këtij vlerësimi të ndikimit dhe në mungesë të ndërhyrjes me këtë politikë, supozojmë se niveli i jodizimit të kripës apo cilësia e kripës së jodizuar, pa një forcim të zbatimit të ligjit dhe ndarje të qartë të kompetencave mes organeve përgjegjëse, vështirëson/nuk përmbush objektivin themelor për parandalim dhe eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike, që sjell pasoja në shëndetin publik, me fokus popullatën. Kjo është në kundërshtim me faktet e përdorura në këtë vlerësim:

Duke qenë se monitorimi, do të kryhet prej DRSH dhe DSHP, dhe këto struktura janë të ngritura tashmë- ekzistuese, nuk parashikohet të ketë kosto administrative për efekt të ngritjes së strukturave të reja që do të realizojnë procesin monitorues, sepse *“me këtë politikë synohet të mbulohet monitorimi ku deri më sot DRSH, DSHP nuk kanë **pasur kompetencën si atribut-e drejtë -detyrim që rrjedh nga ligji**, për shkak se procesi i monitorimit, si më sipërshpejguar nuk ka pasur një përcaktim ligjor që të reflektonte ndryshimet ligjore që prekën rolin e institucioneve aktuale.”*

-Lidhur me tarifat për kryerjen e analizave laboratorike:

-Në rastin e kontrollit në pikat doganore, tarifa paguhet nga biznesi dhe është e detyrueshme, kundrejt lëshimit të fletëanalizës prej DRSH. Lëshimi i kësaj fletëanalize lejon futjen në territorin e RSH të kripës ushqimore të jodizuar. Aktualisht këto tarifa janë të përcaktuara me Urdhër të MSH, “Lista e çmimeve për shërbimin ndaj të tretëve në sektorin e higjenës, epidemiologjisë, dhe Inspektoritativ Sanitar Shtetëror” **të cilat janë zbatuar dhe vlejnë si të zbatueshme deri më sot.**

-Lidhur me **monitorimin në pikat e prodhimit, tregtimit në vend,** DRSH dhe DSHP nuk lëshojnë fletëanalizë, por monitorimi bëhet për efekt të informacionit që duhet për kripën që prodhohet, tregtohet në vend, duke raportuar kështu edhe në organin epror (MSHMS) mbi situatën.

Këto fakte dëshmojnë në favor të synimit të këtij projektligji: në përmirësimin e ligjit dhe forcimin e zbatimit të tij për arritjen e standarteve për konsumimin e kripës së jodizuar në popullatën shqiptare, sepse për të siguruar që kripa e jodizuar është brenda standarteve duhet që të përcaktohet roli i strukturave monitoruese dhe inspektuese të përfshira në mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës.

NDIKIMET EKONOMIKE

Projektligji që po propozojmë nuk parashikon të ketë ndikime financiare direkt në buxhetin e shtetit, sepse zbatimi i projektligjit që po miratojmë i referohet strukturave aktuale për zbatimin e legjislacionit për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizëm. Projektligji mund të parashikojë efekt financiar për operatorët e biznesit ushqimor që importojnë kripë ushqimore. Aktualisht këto subjekte paguajnë një tarifë në vlerën 350 lekë për analizimin e nivelit të jodit në kripën e importuar. Sqarojmë se kjo tarifë është e përcaktuar në urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë të vitit 1998. Me hyrjen të projektligjit është përcaktuar nxjerrja e një udhëzimi të përbashkët me Ministrinë përgjegjëse për Financat lidhur me rishikimin e tarifave të mësipërme. Ende nuk mund të

përcaktojmë nëse do të ketë rritje të tarifës apo ulje të saj. Vlerësimi i vendsosjes së tarifave do t'i referohet kostove administrative për kryerjen e këtyre analizave.

-Parashikohet të ketë *përfitime ekonomike jo të drejtpërdrejta*(në nivel makroekonomik), sepse me marrjen e masave drejt përcaktimit të rolit të institucioneve në mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës, ndarjen e kompetencave, duke forcuar kështu zbatimin e ligjit për rritjen dhe përmirësimin e standarteve drejt sigurisë, cilësisë së konsumit të kripës, rritet aksesimi i popullatës në kripë të jodizuar dhe marrjen e nevojshme të Jodit; në këtë mënyrë rritet mundësia për parandalimin e çrregullimeve që vijnë prej pamjaftueshmërisë jodike. Rrjedhimisht sigurohet jeta, shëndeti, rritet produktiviteti i shoqërisë dhe parandalohen kostot e shërbimit shëndetësor dhe të paaftësisë.

“Bazuar në raportin e Copenhagen Consensus 2012- për çdo dollar të shpenzuar në përmirësimin e gjendjes së ushqyerjes së popullatës (ku përfshihet edhe lufta kundër pamjaftueshmërisë jodike) përfitojmë 30 \$ kthim në produktivitetin e shoqërisë.”

NDIKIMET SOCIALE:

Politika që propozohet, do të ketë *përfitime (efekte) të drejtpërdrejta sociale*: që lidhen me përmirësimin e mirëqenies dhe shëndetit të popullatës.

Politika e propozuar do të sjellë *përfitime (efekte) jo të drejtpërdrejta sociale*: lidhen me mbrojtjen e të drejtës së njeriut, si një e drejtë kushtetuese që shtetasit e Republikës së Shqipërisë kanë për të gëzuar në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj politike synohet përmirësimi i sigurisë dhe qëndrueshmërisë i cili lidhet me shëndetin publik, duke u mundësuar nga shteti një mjedis i shëndetshëm dhe me standartet më të larta shëndetësore, në drejtim të ofrimit të cilësisë së jetës në komunitet, si dhe garancisë në zhvillimin social.

Jodizimi i përgjithshëm i kripës, si çdo ndërhyrje tjetër shëndetësore kërkon një sistem efektiv monitorues dhe vlerësues. Sipas fakteve, ku vazhdimi i situatës së deficiencës jodike përbën ende problem për shëndetin publik bën të domosdoshëm reflektimin mbi situatën për të verifikuar ecurinë dhe qëndrueshmërinë e procesit dhe efektivitetit të tij.

Ndonëse metodat e sigurimit të cilësisë janë të përcaktuara dhe aplikimi i tyre mbetet përgjegjësi e prodhuesit të kripës, shteti si organ rregullator nëpërmjet kësaj politike ndërhyr me ndryshime ligjore në funksion të forcimit të zbatimit të ligjit ekzistues si dhe përcaktimin e rolit të institucioneve përkatëse për zbatimin e tij.

Me politikën e propozuar, synohet të përmbushet objektivi i konsumit vetëm të kripës ushqimore të jodizuar që lidhet me krijimin e një mjedisi të përshtatshëm, fakt që e ben kripën e jodizuar në nivelet e duhura, të jetë gjërësisht e disponueshme.

Në këtë mënyrë, garantohet cilësia e jetës në komunitet, pasi:

Mbrojtja e shëndetit të njeriut, duke parandaluar me synim eliminimin përfundimtar të deficiencës mentale, të uljes së koeficientit të inteligjencës, të kretenizmit, të reduktimit të kapacitetit konjektiv që prek gjithë popullsinë si rezultat i deficiencës jodike, do të ndikojë gjithashtu edhe në cilësinë e jetës në komunitet duke sjellë një mjedis të shëndetshëm ku jetësohet zhvillimi social dhe produktiviteti i popullatës.

Mbrojtja e shëndetit të kafshëve:

Përbën fakt që edhe bagëtitë kanë nevojë njëlloj si njerëzit për kripë të jodizuar, në funksion të sigurimit të shëndetit të tyre.

Për më tepër, ushqimi i kafshëve/bagëtime *me kripë të jodizuar* ndikon në aftësinë e tyre për të gjenuar prodhimtarinë për të cilën ka nevojë njeriu dhe shoqëria. Referuar, zinxhirit ushqimor natyror, kafshët përbëjnë një hallkë të rëndësishme prej të cilit sigurohen produktet e nevojshme dhe bazike për jetesën e individit dhe shoqërisë.

Me propozimet e kësaj politike për forcimin dhe përmirësimin e zbatimit të ligjit drejt qëndrueshmërisë së programit të jodizimit të përgjithshëm, do të shtrihen efektet edhe në *industrinë ushqimore*, ku roli i saj është i rëndësishëm në industrializimin e produkteve dhe nënprodukteve ushqimore të cilat përpunohen paraprakisht me kripë të jodizuar dhe përdoren për konsum human.

Në këtë mënyrë rezulton të ketë përfitim të drejtpërdrejtë social në mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë.

Nëpërmjet një mjedisi më të shëndetshëm, eliminohen kërcënimet serioze dhe reale për zhvillimin social, ekonomik, pasi një popullatë e shëndetshme arrin të investojë në produktivitet social dhe ekonomik.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i rekomanduar është Opsioni 2:

Ndryshime në ligjin ekzistues, pasi në kushtet aktuale nëse nuk bëjmë asgjë, atëherë mbetet i paqartë si dhe konfuz fakti se si mund të arrihet të matet zbatimi i detyrimeve ligjore të çdo institucioni në drejtim të kontrollit të cilësisë së kripës së jodizuar.

Opsioni 2, konsiderohet si opsioni i vetëm që arrin objektivat e politikës ligjërish, pasi nëpërmjet ndryshimeve ligjore do të përcaktohet roli konkret i institucioneve përgjegjëse **për mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës së jodizuar**, gjithçka në funksion për rritjen dhe arritjen e standarteve për konsumimin e kripës së jodizuar në popullatën shqiptare.

- nëpërmjet ndryshimeve ligjore synohet të pasqyrohet një ndarje e qartë e kompetencave mes strukturave lokale të ISHSH dhe DRSH-ve/DSHP sa i takon procesit të kontrollit të jodit në kripë dhe një nevojë për bashkëpunim të mirë mes këtyre dy strukturave.

Mos marrja e masave me ligj (për dhënien e kompetencave, ndarjen e detyrave për mënyrën e kryerjes së kontrollit të kripës së jodizuar), nuk ofron rritje të sigurisë dhe cilësisë së kripës së jodizuar.

Kjo sjell/ këto elementë ndikojnë në problemet shëndetësore/çrregullimet që vijnë nga pamjaftueshmëria jodike.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Institucionet që ngarkohen me zbatimin dhe monitorimin e opsionit 2 (të preferuar) janë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ISHP dhe ISHSH të cilët do kryejnë veprimet si më poshtë:

1. Do të vihen në dispozicion institucionet e varësisë me specialistë dhe laboratorët përkatës (DRSH/DSHP) për ushtrimin e kontrolleve në dogana, stabilimentet e jodizimit si dhe në treg (pikat e shumicës dhe pakicës ku tregtohet kripa ushqimore).
2. Monitorimi do të kryhet gjatë gjithë vitit dhe raportimi do të bëhet çdo tre muaj mbi situatën. (Monitorimi në terren).
3. ISHSH do të kryejë inspektime sipas një plani të përcaktuar në subjekte të ndryshme të cilat prodhojnë, importojnë apo tregtojnë kripën ushqimore.
4. Nëse gjatë kontrolleve të ushtruara konstatohen raste të mos respektimit të standardeve të vendosura në ligj dhe aktet nënligjore, ISHSH është përgjegjës për vendosjen e masave administrative sipas rastit.
5. ISHP kryhen studime për vlerësimin e përdorimit të kripës ushqimore të jodizuar në nivel familje dhe matjen e marrjes së jodit në popullatë (joduria).

Gjithashtu çdo subjekt importues, prodhues apo tregtues i kripës ushqimore të jodizuar ka në dispozicion numrat e kontaktit (DRSH, DSHP/ASHR, DRISHSH) për çdo ankesë.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Projektligji i është nënshtruar procesit të RIA. RIA u plotësua dhe u la për konsultim në faqën zyrtare të internetit.

Pas konsultimit të RIA ka pasur edhe sugjerime nga grupe të interesit (kompani që fortifikojnë kripën në vend).

Projektligji është ripunuar duke marrë në konsideratë kërkesën e palëve të interesit për lejimin e hyrjes në vendin tonë të kripës së pafortifikuar vetëm me qëllim fortifikimin.

Sugjerimet e tjera për lejimin në treg edhe të kripës së pajodizuar (kripa himalaje) duke e lënë kështu në dëshirë të konsumatorit nuk u morën parasysh pasi dalin jashtë frymës së ligjit për të mos lejuar që në treg të ketë kripë të pajodizuar.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										

Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total										

Ne identifikojmë përfitimet jo të drejtpërdrejta, të cilat në këtë fazë nuk mund t'i monetarizojmë dhe kjo matet nëpërmjet studimeve që bëjnë të mundur përqindjen e popullatës së prekur nga pamjaftueshmëria jodike, si dhe bazuar në studime të huaja si:

“Raporti i Copenhagen Consensus 2012- për çdo dollar të shpenzuar në përmirësimin e gjendjes së ushqyerjes së popullatës (ku përfshihet edhe lufta kundër pamjaftueshmërisë jodike) përfitojmë 30 \$ kthim në produktivitetin e shoqërisë.”

Bazuar në këtë raport- studim përforcohet dhe faktohen përfitimet jo të drejtpërdrejta ku nëpërmjet realizimit të objektivave të vendosur për këtë politikë sigurohet qasja e popullsisë në kripë të jodizuar, gjë e cila rrit mundësinë për parandalim që është dhe vetë synimi i ligjit. Nëpërmjet parandalimit rritet mundësia për eliminim të çrregullimeve që vijnë nga pamjaftueshmëria jodike. Me eliminimin, sigurohet që problemet në shëndet me shkak çrregullimet jodike të jenë inekzistente, e kështu parandalohen kostot për shërbimin shëndetësor, dhe ky është fakt.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			